

PARATHËNIE

Ardhja e Pjetër Metës në letërsinë politike shqiptare

Prof. dr. Bardhosh GAÇE

Çdo libër i shkruar, që i vihet në dorë lexuesit është një shërbim i mirë që i bëhet vendit. Marrëdhëniet e njerëzve me shoqërinë ,historinë ,zhvillimin, kulturën ,raportet sociale të shtresave shoqërore janë të ndryshme. Pavarësisht një përvoje shekullore, që na vjen përmes librave, autorëve të dëgjuar, të cilët diktojnë zhvillimin përmes zbulimit të realitetit shpirtëror, ekonomik, politik, përmes shoqërisë dhe njerëzve, që vihen në shërbim të kësaj shoqërie, qasja individuale dhe vëzhgimi i realitetit individual, nuk është i mundur kurrë të kolektivizohet. Kjo është një nga mrekullitë njerëzore, të cilën vazhdojnë të ushqejnë ,ta pasurojnë dhe ta bëjnë të larmishme historinë njerëzore në opinionet për të.

Në shkrimin e librave dhe botimin e tyre ka një seleksionim të çuditshëm, të pakthyeshem pas, veprues ngadalë, mençurisht i pagabueshem, i verifikueshem jo nëpër ex- katedrat e titujve apo gradave shkencore, por në rrjedhën e kohës dhe të zhvillimeve njerëzore, sociale dhe historike gjithashtu. Jo pak libra, që nga antikiteti i lashtë, kanë zënë vend si gurët e kështjellave apo kalave, të cilët pavarësisht luftërave, betejave, të goditurit mbi to dhe nga murtaja, pavarësisht ciflimit, çarjeve apo dhe përgjysmimit të tyre, kanë mbetur aty, si një këshillim, si një kujtesë e pa- zhbëshme, si një nevojë sublime për njerëzimin.

Dhjetëra vepra dhe autorë, librat e të cilëve kanë arritur deri në ditët tona moderne përmes refuzimeve, konflikteve politike, konflikteve historike apo debateve akademike, janë gurë të çmuar të dijes, mençurisë dhe universalitetit njerëzor të ditëve të sotme. Betejat e librave janë betejat më të ashpra, më jetëgjata, më të vështirat, por betejat që zakonisht nxjerrin fituesit e vërtetë, pavarësisht humbjeve të përkohshme vazhdojnë gjatë. Vdesin autorët, rinojnë shkollat publicistike apo kulturore dhe lindin shkolla të tjera, ndërsa betejat e librave vijojnë, kështu që jetën njerëzore e kanë mbajtur në këmbë dhe në rrugëtimin e tyre të pandalshëm, pikërisht rezistenca e librave të mirë.

E nisa këtë qasje emblematike mbi historinë dhe mbijetesën e librave për një shkak të thjeshtë,- gjithçka e shkruar seleksionohet nëpër kohë, nëpër zhvillimet reale të shoqërisë dhe të mendimit, sado të refuzohet apo të mbivlerësohet një libër në një kohë të caktuar.

Kam pasur rastin ta njoh mirë, në thelbin e vet Veriun e Shqipërisë, ta njoh në realitetin jetësor, pra jo vetëm përmes shkrimeve dhe kumtesave historike apo folklorike, përmes të cilëve ka tejkallimet e veta çdo interpretim. Kam kaluar ditë- net vere dhe dimri në shtëpitë dhe kuvendimet me malësorë, dhe kjo kohë ka mbetur një realitet jetësor brenda meje dhe pse kanë kaluar shumë kohë. Ndoshta, ndryshe shumë komunikuesve të tjerë librorë, për autorët e këtyre trevave, unë arrij të kuptoj dhe atë pjesën e padukshme, nënshtresat dhe metaforën, që zakonisht ka krijimtaria e këtyre anëve.

Mjediset, psikologjinë dhe kulturën bazike të anëve ku është lindur dhe rritur Pjetër Meta, mendoj se do ta kishte zili çdo njeri i letrave, jo vetëm atyre historike apo letrare, por dhe politike, për shkakun e një lidhjeje të fortë, që zakonisht i imponojnë njëra-tjetrës këto fusha të dijes dhe të kumtimit njerëzor. Pjetër Meta është një emër i dëgjuar në fushën e letrave, jo për shkak të botimit të tri librave , “Gruaja që sfidoi fatin”, “Fundi i kalvarit” dhe “Ka thënë Pal Kokrri (Neçaj)”, libra të cilët sjellin një qasje të rëndësishme për trevën e autorit dhe të veriut, por për çfarë ka shkruar. Një njeri i letrave kuptohet mirë që në momentin e parë se për çfarë shkruan, zgjedhjen e temave dhe çështjeve që e shqetësojnë. Këta ekuilibra të brendshëm janë një lloj recepsioni i kulturës, dijes dhe personalitetit që ka një person i tillë.

Mendoj se personaliteti publik shkrimor i Pjetër Metës do të vijojë në të ardhmen bashkë me rivlerësimin kritik, publicistik, dokumentar dhe historiografik, me qasje etnopsikologjike të sjelljes në kujtesën kombëtare të një ngjarjeje të rrallë, atë që shtjellon libri emblematik i tij “Gruaja që sfidoi fatin”. Libri në fjalë tejkalon kufirin e vet, jo pse risjell në kujtesën dhe vëmendjen e shqiptarëve një ngjarje njerëzore, një ngjarje që është e zorshme të përfytyrohet, por për gjithë-kohësinë e saj, çështjen e mbijetesës në konceptin e lirisë njerëzore.

Pavarësisht raporteve që Pjetër Meta ka pasur me kohën, raportet që ai i ka dhe në ditët e sotme, përmes një libri të tillë, i cili në themelin e tij, fabulën dhe valorizimin e ideve dhe nëntekstet e shumta të tij, e ekspozon autorin si një intelektual të formuar besueshëm, një njeri me një dimension njerëzor, një mjeshtër letrash. Humanizmi

njerëzor, kontekstualiteti i ngjarjeve dhe zbulimi i ngjarjeve të tilla, që për fatin e mirë është pronë autentike e një treve të njohur për cilësi të spikatura, siç është Tropoja.

Mendoj se Pjetër Meta i ka bërë një shërbim të rrallë Tropojës dhe vendit, pasi historia, përtej përfytyrimit njerëzor është sistemuar në një libër brilant mes letërsisë dhe historisë, por unë do të kërkoja që libri në fjalë ("Gruaja që sfidoi fatin") duhet t'i propozohet një lexuesi të gjerë, një lexuesi bashkëkohor, qoftë dhe jashtë vendit.

Tashmë kam në dorë një libër të ri të autorit, të një natyre tjetër, ku emri i intelektualit Pjetër Meta kërkon të bëjë rrugën e vet në letërsinë politike shqiptare. Në dukje, letërsia politike duket e lehtë, por është akoma më e vështirë se historia apo romani, për shkakun e një raporti të rëndësishëm funksional, që ajo duhet të përmbushë, atë të realitetit me analitizmin ideor. Politika, pastaj ka një rivlerësim dhe një funksionalitet të ideve politike, të cilat rrjedhin nga zhvillimet historike të shoqërisë njerëzore në praktikën e veprimtarisë njerëzore, qoftë kur ato sjellin progres, qoftë kur nuk sjellin ndonjë zhvillim të caktuar.

Libri i ri i Pjetër Metës, i titulluar *"Tranzicioni politik shqiptar dhe fenomeni Rama"* është një libër emblemantik, në të cilin autori ka marrë një ngarkesë të konsiderueshme, për arsyen e thjeshtë se; ai nuk u është shmangur raporteve dhe marrëdhënieve vertikale me ato horizontale, të cilat vijojnë në të gjithë librin, i cili është voluminoz. Kjo ka qenë një nga strukturat e vështira të librit, pasi libra të kësaj natyre kanë një lloj analitizmi të rëndësishëm dhe preferencial. Pavarësisht një lloj protagonizmi të dukshëm njerëzor, në kuptimet përfaqësuese të zhvillimeve historiko-politike, ajo që bie në sy në libër është praktika e koncepteve, të cilat përgjithësisht janë të qëndrueshëm dhe funksional.

Në këtë kuptim, në praktikën e punës së studiuesve, qofshin në paraqitjen e librave, qofshin në mbështetjet e këtyre librave, funksion të rëndësishëm marrin konceptet. Kështu jam i prirë, që në këto shënime paraqitëse të librit të parë në këtë fushë publicistike të Pjetër Metës, të flas mbi konceptet, që autori i ka vënë në funksion dhe të personazheve apo protagonistëve. Për një studiues rëndësi kanë konceptet. Dua të vë në dukje një logjikë racionale, e cila ka ndihmuar të ruajë ekuilibrin e ideve, për arsyen se ai ka ditur të zgjedhë referencën, të cilës nuk i është larguar dhe në momente kur ka pasur kapërcime apo shtjellime horizontale të gjera.

Dhe pse në analizën politike, e cila ka qenë e "detyruar" të kalojë nga koha në kohë, në përfytyrimin dhe logjikën e autorit, e cila ka një mbështetje racionale në kulturën dhe

dijen e tij historike dhe politike, çështja më e rëndësishme mbetet shteti edhe pse terminologjia për të ka ndryshuar nga koha në kohë. Perceptimet mbi 100 vjet qeverisje shqiptare dhe kritika politike- sociale që Pjetër Meta e ka zhvilluar në rrethanat e zhvillimeve të brendshme shqiptar, në fund të fundit i referohen kohës që jetojmë ne sot. Mendoj se autori ka vepruar mirë në këtë aspekt. Jo pak autorë të vendit dhe të huaj, gjithmonë sipas koncepteve dhe aftësive vetjake të interpretimit të zhvillimeve sociale- politike dhe historike, kanë pasur një lloj “dakordësie”, pasi i kanë parë gjërat nga faktori i brendshëm shqiptarë. Kjo qasje është e rëndësishme, pasi kohët e kanë vërtetuar se problemi ynë më së shumti gjatë kohëve kemi qenë ne vetë.

Lufta politike që shqiptarët i kanë bërë njëri- tjetrit në këto 100 vite, në betejën për të ndërtuar shtet, në kuptimin e plotë të fjalës vazhdon të jetë një plagë qorre, që ne vazhdojmë t’ia hapim vetes rast pas rasti dhe kohë pas kohe. Të gjithë qeveritë e këtyre 100 viteve, kanë hyrë në vështirimin e autorit si një problem i vazhdueshëm i vetë shqiptarëve, zgjatimet e të cilave janë produktive dhe në ditët tona. Herë pas here autori iu referohet rasteve të tilla për të njoftuar lexuesin me këtë përvojë të hershme. Shqiptarët janë bërë bashkë për çështje strategjike, por kur ka qenë e nevojshme të kenë një qeveri që të kujdeset për të gjithë dhe t’i drejtojë ata me sukses drejt zhvillimit, janë kthyer në kundërshtarë të patolerueshëm me njëri tjetrin. Kapitulli në fjalë shërben si një “skedë” e nevojshme, për të kuptuar një problem tradicional shqiptar.

Pjetër Meta është një publicist i hapur, por në të gjithë hapësirën që krijon në libër ai ka një inteligjencë të çuditshme, për të cilën duhet një sy studiuesi për ta kuptuar. Libri në dukje të parë duket se është ngritur mbi një gjuhë publicistike dhe komunikuese, për lexuesit e të gjithë niveleve të shoqërisë, por ai ka një analizë racionale, pasi autorit nuk i shpëtojnë në asnjë situatë dhe kohezion çështjet e rëndësishme sociale.

Ashtu siç kumtohet që në titull, autori ka afruar një qasje politike, dhe ky është qëllimi i librit, por pavarësisht kësaj, vetëm një marrëdhënie e tillë do ta “sterilizonte” librin, do ta linte atë pa aksesoret e nevojshëm, pa proteinë. Në këtë këndvështrim, zhvillimet e viteve “90-të, Pjetër Meta ka veçantinë e arsytimit me syrin politik dhe syrin ekonomik, profesion për të cilin është diplomuar në universitet dhe të cilin e ka ushtruar gjatë gjithë jetës nga niveli më i thjeshtë deri në nivelet e larta të shoqërisë.

Ky këndvështrim e bën opinionin e tij të besueshëm dhe racional. Ndërmarrja e lirë, veçmas në vënien në punë të plotë të intuitës ekonomike, me resurset e shumta që ka Shqipëria, ka nxjerrë në pah një kalkulim të mprehtë të autorit, për të shpjeguar

realitetin shqiptar. Ai është i sinqertë, i guximshëm dhe kurajoz, kur pa pendesë politike na tregon nevojën pse vendi duhej të ndryshonte sistemin, ëndrrat që i janë krijuar atij, familjes si gjithë shqiptarëve të tjerë, por dhe zhgjëndrrën. A pati vërtetë një zhgjëndërr tek shqiptarët, sapo ata prekën lirinë si një model i praktikuar mjaft suksesshëm në botë, kryesisht në Perëndim? Po, autori është i besueshëm, kur i referohet një çështje të tillë, veçmas në vitin “97, parë në problemet sociale që krijuan ngjarjet e paprecedent në vend, pavarësisht referencave politike që u përdorën në këtë kohë.

Libri politik *“Tranzicioni politik shqiptar dhe fenomeni Rama”*, duket se ka një lloj protagonizmi politik, i njoftuar përmes një termi të njohur tashmë në fjalorin politik botërorë “lider”, por nuk është plotësisht i tillë. Pjetër Meta, nuk mund t’i ndërtojë pozicionet dhe opozicionet politike pa argumentet e fushës që ai i njeh mirë, dhe kjo mendoj unë e ka bërë librin e tij interesant. Autorin e motivon në analizat e tij polarizimi politik shqiptar dhe protagonizmi i liderëve, ku bie në sy një farë shpërdorimi i lirisë (nuk ka gjë më të trishtuar në politikë apo në një fushë tjetër që të keq- përdorësh lirinë), por kjo i ka pasojuar Shqipërisë dhe zhvillimit social- ekonomik një sëmundje fatkeqësisht të vuajtur shumë nga shqiptarët, një tranzicion të gjatë. Në gjithë nëntekstin e ngjarjeve politike, tranzicioni është një refren, një “rregjim kazerme” për Shqipërinë dhe shqiptarët, dhe ajo që është më e keqja, ka të bëjë me vrasjen e ëndrrës, zhgënjimin nga “ylli politik” i viteve “90-të. Vrasja e një ëndrre të bukur, një ëndrre që kishte lindur dhe ishte ndezur në buzë të greminës së fund-viteve “80-të dhe fillim viteve “90-të, ishte një lloj “Mit Sizifi”.

Në këtë aspekt, autori ka një dëshpërim të thellë, deri në vuajtje, e me këtë rast, ai i drejtohet komunikimit përmes mjeteve të informimit, siç janë gazetatat e përditshme, për të qenë më afër mendësisë dhe korrektimit politik popullor. Mendoj se autori ka pasur akoma mundësi për të gjetur referencë më të madhe dhe më funksionale librare dhe shkrimore, pavarësisht se libri është afër llojit të publicistikës komunikuese.

Në “dramën” e pluralizmit dhe të lirisë, drama e lirisë është e dhimbshme, Pjetër Meta arrin të risjellë atë kalvar politik, i cili ka vijuar në rrugëtimin 100 vjeçar të shtetit dhe të qeverive shqiptare, d.m.th veset e vjetra, që i futën gurë në rrota të ecurit përpara të Shqipërisë dhe të vendit.

Në këtë udhëtim pa dritë të Shqipërisë dhe shqiptarëve, autori arrin të nxjerrë nga rrëmuja, kaosi dhe stresi politik popullor protagonistët, që për mënyrën se si Pjetër

Meta e ka shtruar librin që në fillim, ata duken që nga momenti i parë kur ai ka nisur të shkruajë librin e tij, e deri në fundin e tij. Në pamjen e parë protagonistët duket se zënë të gjithë librin, por kjo nuk është e vërtetë. Autori është mjeshtër i krijimit të situatës së protagonistëve, por librin e mbajnë në këmbë gjëra më bazike dhe më racionale, analiza ekonomike më së pari dhe koncepti qenësor si një motivim dhe shpresë për popullin, koncepti mbi shtetin e vërtetë. Metafora e përdorur dendur në letërsi dhe në politikë, ajo e “dritës në fundin e tunelit” dhe në librin “*Tranzicioni politik i Shqipërisë dhe fenomeni Rama*”, është e “shtrirë” me një deduktivitet të pranueshëm në të gjithë librin, sepse në libra të kësaj natyre është e vështirë të ndërtosh detaje si në librat artistik,

Pjetër Meta është dëshmuar një njeri me ndikim dhe formim të dukshëm social, sepse në gjithë librin, identifikimi i raportit social me zhvillimet në vend është i pranishëm. Pikërisht në këtë sendërtim social, në këtë lloj komunikimi, autori merr shkas të flasë për liderin politik që i duhet vendit dhe të cilin ai e beson dhe për të cilin beson se do të mund të përmbushë pozitivisht sakrificën sublime të shqiptarëve.

Drejtuesin e ri politik të të majtës shqiptare, Edi Rama, publicisti Pjetër Meta e gjen më së pari në mjedisin mbijetues shqiptar, pikërisht në nevojën e shqiptarëve për dritë dhe guxim, por pa iu shmangur aspak thelbit social të rëndësishëm të Shqipërisë dhe të shqiptarëve, çështjeve ekonomike. Autori ka një epërsi të padiskutueshme në krahasim me shumë autorë të tjerë, të cilët kanë shkruar për politikën dhe tranzicionin shqiptar, qasjen e interpretimit ekonomik të zhvillimeve në vend.

Jam i prirë ta besoj dhe të mbijetojë në zhvillimet politiko- sociale nëpër të cilat po kalon Shqipëria çështja e liderit, të cilës autori i librit i beson shumë. Teza të tilla duhet kohë të vërtetohen, por rrugëtimi politik i Edi Ramës sapo ka filluar. Mbijetesa e ideve të tij politiko- sociale duhet kohë dhe rrethana të reja të vërtetohen, ato duhet të fillojnë të jetësohen në jetën dhe veprimtarinë ekonomike të vendit dhe të shtetit ligjor.

Pjetër Meta është përpjekur ta shohë në dy rrafshe të dukshme nga të gjithë liderin politik Edi Rama, në veprimtarinë praktike, të punës së tij si njeriu, që është kurajoz, guximtarë dhe me një projekt social, i cili më së shumti është brenda koncepteve të tij dhe në rrafshin tjetër të dukshëm dhe të përditshëm, në luftën politike me kundërshtarin politik, që zakonisht është lideri tradicional i të djathtës shqiptare.

Përmes ngjarjeve të shumta politike, protagonistëve të tjerë politik, të majtë dhe të djathtë, Pjetër Meta ka arritur të sjellë një perceptim real, se 25 vitet e pluralizmit politik janë shndërruar në një luftë, e cila në fund të fundit as më pak as më shumë, ka qenë një

betejë kolltukësh. Por duke qenë një njeri me intuitë të zilishme ekonomike, autori në kontekstin e gjithë librit përcjell një lloj logjike ekonomike dhe pse ai i ka mëshuar disi shumë politikës në rast pas rasti. Në politikë ka rregullsi të ndryshme, të cilat duhen njohur mirë nga protagonistët. Rama ka shërbyer mjaft mirë dhe me sukses në kushtet e të qenit anëtar i një kabineti qeverisë dhe për një kohë ta gjatë kryebashkiak i Tiranës, janë dy momente që atë e ekspozuan mjaft mirë në opinionin politik shqiptar dhe përëndimor, si një njeri i nevojshëm dhe i rëndësishëm i drejtimit të vendit. Ka qëndruar për 8 vite në krye të opozitës politike shqiptare të majtë, kur vendin e drejtonte e djathta dhe kundërshtari politik i Ramës. Përgjithësisht ky është kohezioni social dhe politik në të cilën u ngrit ylli politik i Edi Ramës.

Ligjësoritë politike nuk lejojnë t'i shmangesh dialektikës së zhvillimeve, dhe kur ato janë krejtësisht politike. Te qenët në opozitë krijon mundësi të shumta meditimi, aksioni politik në kontakt të drejtpërdrejtë me elektoratin, saktësisht socialitetin për të përvetësuar me realizëm nevojat, mundësitë dhe perceptimin që njerëzit kanë për kundërshtarin politik, i cili është në drejtimin e vendit. Natyrisht kjo është mundësia me oportune për të ndërtuar dhe tezat teorike për t'i propozuar elektoratit një projekt kurajoz dhe të besueshëm. Lideri politik i Pjetër Metës dhe i të majtës shqiptare, arriti ta bëjë këtë, por përmes një konfliktualiteti jo të zakonshëm. Në momentin kur rikthehesh në pushtet, idetë politike të ngritura në kushtet e opozitës, duhet të fillojnë praktikumin e tyre për t'u vërtetuar, pavarësisht raporteve të forcave dhe fuqisë që ka qeveria paraardhëse. Edi Rama është në këtë proces .

Marrja e pushtetit në vitin 2013, ashtu siç shënova pak më lart, përmes një programi testues, verifikues dhe emergjent, siç ishin kushtet e Shqipërisë në këtë kohë, dukej se po bënte një farë simbioze të liderit me fenomenin Rama, për të cilin duhet pritur akoma. Mendoj se fuqia prej lideri e Ramës nuk duhet konsideruar saktësisht e gjetur vetëm në luftën e fituar me kundërshtarin politik të njohur Sali Berisha, i cili në një formë apo tjetër ka qenë protagonist i gjithë realitetit politik shqiptar që nga viti 1990, por në produktin social dhe progresin e vendit, në kushtet e qeverisjes prej tij.

Në këto kushte dhe rrethana, pavarësisht protagonizmit politik, Pjetër Meta bën mjaft mirë me elementimin ekonomik të politikës, me ç'rast dalëngadalë do të ulej dhe do të bëhej më qytetar dhe protagonizmi politik në vend. Thënë ndryshe, shqiptarëve u duhet të dakordësohen rreth një opinioni historik, ta duam njëlloj vendin, por themeli

mbeten ligjëSORITë ekonomike, për ta imponuar politikën në verifikimin kohor të fenomenit politik “Rama”, i cili duhet të vazhdojë.

Pjetër Meta, përmes librit emblematic “Tranzicioni politik i Shqipërisë dhe fenomeni Rama”, ndryshe shumë autorëve të tjerë që kanë shkruar për politikën dhe personazhe të njohur të politikës shqiptare, është autori më i sinqertë që kam lexuar. Libri është i integruar mirë në rrjedhat e historisë dhe protagonistëve të saj, që nga 100 vite më parë. Prirja për ta parë me detaje konfliktualitetin e brendshëm shqiptarë, ka një logjikë përgjithësisht të njohur dhe të diktuar nga të gjithë shqiptarët, pavarësisht nivelit intelektual, se pengesa është brenda nesh.

Libri është shkruar me një stil të ngritur publicistik, që do të thotë, përmes një gjuhe komunikuese, ai është i qartë dhe i kuptueshëm për të gjithë lexuesit. Pjesa më e madhe e detajeve, që vijnë përmes eksponentëve të njohur të politikës apo dhe të opinionit mediatic, janë tregues të përditshmërisë me të cilën autori e ndjek dhe debaton për politikën. Duke u dakordësuar për arsyetimet, analizat, diktimin inteligjent të realitetit social- politik, interpretimit ekonomik si domosdoshmëri, duke perifrazuar miqësisht se në “opozitë duhet të jesh yll, të shikohesh si shpresë nga të gjithë dhe në pushtet duhet të jesh diell t’i ndrisësh të gjithë”, dua të besoj se Pjetër Meta ka dhe do të ketë të drejtë.